 REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA E KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY		Nr. Prot. Br Prot. Prot No. <b>03-4523/12</b>
Dep. D. Dep. Dep. <b>DPK / DMP</b>	Nr. D. Dep. D. Dep. <b>02</b>	Data Datum Date <b>18.12.2012</b>

Nr. Regj. 14835/2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurës Armenija Zajmi-Besqeviq, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 10.12.2012 morri këtë:

## AKTVE N D I M

**PEZULLOHET:** Procedura për kundërvajtje ndaj **Armenija Zajmi-Besqeviq**, e lindur më 08.05.1953 në Prishtinë, me vendbanim në rrugën “Lagja e Universitetit”, nr. 79, në Prishtinë, ka kryer shkollën e mesme, me profesion fotoreportere, për kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, **konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se nuk ka prova se ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë.**

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

## A r s y e t i m

**Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë**, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-1617/2012 me datë 02.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj Armenija Zajmi-Besqeviq, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion, nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2012.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të Armenija Zajmi-Besqeviq e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se në postin e Zyrtares së lartë publike si Këshilltare politike në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk ka qenë asnjë herë pasi që me profesion është fotoreportere dhe është e vërtet se një kohë ka punuar si fotoreportere e jo si Këshilltare politike duke ia prezantuar gjykatës shkresën nga Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me nr. Të protokollit 113-1210 të datës 12.11.2012 ku thuhet se është bërë gabimi i kodeve i cili është korrigjuar ku është kuptuar gabimi dhe e njëjta nuk ka qenë këshilltare politike .


Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi Përfaqësuesin e kërkesës Agron i cili deklaroi se nga Ministria ka kërkuar informata shtesë dhe të njëjtë e kanë informuar se ka qen një gabim që është vendos në listën e zyrtarëve të lartë Armenija Zajmi-Besqeviq due ia prezantuar dhe marrëveshjen e veçantë të lidhur me Armenijen mbi kthimin e të hollave të cilat i ka marr pasi që ka ardhur deri te gabimi në kode dhe e njëjta është hequr nga ajo listë e pagave.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimin të deklaratës së të pandehurës, deklarata e përfaqësuesit të Agjencisë kundër Korrupsion Agron Behramit, vlerësimin të shkresave të tjera të lëndës, gjyqtarja ka konstatuar Armenija Zajmi-Besqeviq nuk ka qenë Zyrtare e lartë publike –këshilltare politike në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal andaj nuk ka kryer kundërvajtjen dhe në vështrim të nenit 198 par. 1 pika 8 të LK, **pezulloi** procedurën për kundërvajtje në mungesë të provave.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
**Nr. Regj. 14835/2012, datë 10.12.2012**

Gjyqtaria  
Azra Cakolli

  
**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimi të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.